



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO			
ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT			
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
DATE/MAHAR/DREZUAR:			
DATUM PRILIDEN/SOSTAVLJEN:			
DATE RECEIVED/SUBMITTED:			
27.10.2023			
Mision Org. Org. Jedin. Org. Unit	Shif. klasif. Klasif. Kod Class. Code	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Nri faqeve Br. Stranica No. Pages
01	47	1949	26

# PLANI VJETOR I AUDITIMIT

(PËR SEZONIN AUDITUES -1 SHTATOR 2023  
DERI 31 GUSHT 2024)

Prishtinë, tetor 2023



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

# PLANI VJETOR I AUDITIMIT

(PËR SEZONIN AUDITUES -  
1 SHTATOR 2023 DERI 31 GUSHT 2024)

Prishtinë, tetor 2023

## **Tabela e përmbajtjes**

1.VIZIONI, MISIONI DHE VLERAT .....	3
2. HYRJE .....	4
3. AUDITIMET - LLOJET DHE PROCESI I AUDITIMEVE .....	5
4. OBJEKTIVAT E PLANIT VJETOR TË AUDITIMIT .....	9
5. BUXHETI DHE BURIMET NJERËZORE .....	18
6. ZBATIMI I PLANIT VJETOR .....	19
Shtojca 1. Subjektet/temat dhe shuma e buxhetit që do të auditohet.....	20

## 1. VIZIONI, MISIONI DHE VLERAT

### Vizioni

Institucion Suprem i Auditimit i besueshëm dhe model që i shton vlerë përdorimit të fondeve publike.

### Misioni

Nëpërmjet auditimeve cilësore ofrojmë siguri në shfrytëzimin e pasurive dhe parasë publike, me qëllim të përmirësimit të ofrimit të shërbimeve për qytetarë dhe rritjen e llogaridhënies publike.

### Vlerat e Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA)

- **Pavarësia**

Pavarësia nënkupton që i gjithë procesi i auditimit t'i nënshtrohet vetëm kërkesave të standardeve profesionale dhe të jetë jashtë ndikimit të palëve të treta. Pavarësia është elementi kryesor për të siguruar besimin e publikut dhe të Kuvendit të Kosovës, duke u ofruar atyre informacione të besueshme dhe të paanshme.

- **Profesionalizmi**

ZKA udhëhiqet në veprimtarinë e saj audituese nga standardet profesionale të ONISA/INTOSAI dhe nga praktikat më të mira të vendeve.

- **Integriteti**

ZKA angazhohet për mishërimin e vlerave më të mira etike, profesionale dhe morale. Veprimtaria e auditimit kryhet në mënyrë të ndershme dhe jashtë çdo konflikti të interesit.

- **Transparenca**

ZKA është organizatë e hapur dhe do t'i bëj publike të gjitha aktivitetet e saj të rëndësishme. Po ashtu do t'i ofroj publikut të gjerë informacionin e përfituar nga auditimi, në përputhje me rregullat ligjore dhe standardet profesionale. ZKA angazhohet që të promovoj transparencën edhe në subjektet e audituara, si një element i qeverisjes së mirë.

- **Fryma ekipore**

Në ZKA procesi i auditimit kryhet në mënyrë profesionale dhe bashkëpunuese në mes kolegëve në ekip dhe në nivele të ndryshme organizative, kështu promovojmë frymën ekipore si vlerë e shtuar për ZKA-në.

---

## 2. HYRJE

Zyra Kombëtare e Auditimit ("ZKA") si Institucion Suprem i Auditimit ("ISA") kryen auditimin e jashtëm të sektorit publik në Republikën e Kosovës. Mandati dhe kompetencat e Auditorit të Përgjithshëm janë përcaktuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës ("Ligjin e ZKA-së").

ZKA, auditon Pasqyrat Financiare Vjetore (PFV) të të gjitha organizatave buxhetore për të vlerësuar nëse ato ofrojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë dhe nëse paraja publike është shpenzuar për qëllimet për të cilat është miratuar. ZKA kryen auditime të performancës me synim të përmirësimit të shërbimeve për qytetarët dhe vlerës për para.

Ligji Nr.05/L-055 për ZKA-në, respektivisht neni 20 përcakton që AP të hartoj Planin Vjetor të Auditimit (PVA), i cili përfshinë të gjitha aktivitetet audituese për sezonin auditues 2023/24 dhe dorëzohet tek Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike (KMFP), për çdo vit deri më 31 tetor.

Në hartimin e këtij dokumenti është vepruar në përputhje me Ligjin e ZKA-së në përmbushjen e obligimeve kushtetuese e ligjore për auditime të rregullsisë.

<sup>1</sup>Përzgjedhja e temave për auditime të performancës është bazuar në vlerësimin e ndikimit në përmirësimin e mirëqenies së qytetarëve, përmirësimin e qeverisjes dhe mundësinë që të shtoj vlerë në menaxhimin e financave publike. Si proces i rregullt në konsultime me palët e interesit dhe OJQ është vlerësuar niveli i rrezikut (qasjen e bazuar në rrezik). Mbi këtë bazë janë përfshirë edhe auditimet e ndërmarrjeve publike, si dhe adresimi i kërkesave specifike nga kuvendi i Kosovës dhe palët tjera të interesit.

Plani vjetor i auditimit përmban informatat relevante në lidhje me auditimet e përzgjedhura nga Auditorja e Përgjithshme për sezonin auditues, përfshirë projektet, aktivitetet, afatet, burimet e nevojshme, buxhetin, rezultatet dhe rreziqet që mundet të ballafaqohet ZKA.

Auditimet do të realizohen në pajtueshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit ("SNISA"), dhe Korniza e Deklarimeve Profesionale (IFPP). Po ashtu procesin e auditimit e bazojmë në parimet universale të ISA-ve dhe të Zyrës Kombëtare të Auditimit siç janë; pavarësia, profesionalizmi, integriteti, transparenca dhe fryma ekipore. Të gjitha raportet e ZKA-së janë të qasshme për palët e interesuara dhe publikohen në faqen zyrtare të internetit të ZKA-së.

---

1 Megjithëse në ligjin për ZKA përdoret termi auditim i rregullsisë, sipas SNISA-ve të përditësuara nuk përdoret me tutje ky term. Ky lloj i auditimit tashme emërtohet me termin Auditimi Financiar dhe i Pajtueshmërisë, pasi që standardet SNISA-t i trajtojnë ndaras auditimet financiare nga ato të pajtueshmërisë.

### 3. AUDITIMET - LLOJET DHE PROCESI I AUDITIMEVE

Auditimi financiar dhe i pajtueshmërisë ka për qëllim rritjen e nivelit të besueshmërisë së përdoruesve të synuar të Pasqyrave Financiare dhe përdorimi i fondeve publike në pajtueshmëri me autoritetet.

#### 3.1. Llojet e auditimeve

Në përputhje me mandatin dhe fushëveprimin e ZKA-së, gjatë sezonit 2023/24 do të kryhen këto lloje të auditimeve:

- **Auditime financiare dhe të pajtueshmërisë** të organizatave buxhetore dhe të ndërmarrjeve publike;
- **Auditime të pajtueshmërisë**; dhe
- **Auditime të performancës, përfshirë auditimet e teknologjisë së informacionit.**

**Auditimi Financiar dhe i Pajtueshmërisë:** përfshinë auditimin e Pasqyrave Financiare Vjetore të institucionit me qëllim të vlerësimit nëse raportet financiare janë të besueshme dhe pasqyrojnë rezultatet e realizimit të buxhetit në mënyrë të drejtë; vlerësimin nëse menaxhmenti u është përmbajtur ligjeve dhe akteve nënligjore të zbatueshme dhe nëse fondet janë përdorur për qëllimet e synuara; vlerësimin e funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar, funksionet e auditimit të brendshëm dhe sistemet e kontrollit të brendshëm.

Objektivat e auditimit financiar dhe të pajtueshmërisë përkufizohen si siguri e arsyeshme, e cila i ofrohet shfrytëzuesve të Pasqyrave Financiare, nëse Pasqyrat Financiare të audituara janë në tërë kuptimin material të vërteta dhe të drejta (apo të paraqitura drejtë) dhe nëse transaksionet e raportuara në ato pasqyra janë kryer në pajtueshmëri me autoritetet.<sup>2</sup>

Auditimet financiare dhe të pajtueshmërisë kryhen për çdo vit. Procesi i auditimit fillon në shtator, ndërsa raportet e auditimit për OB-të individuale publikohen deri në fund të muajit qershor. Cikli i auditimeve përmbyllet në fund të muajit gusht kur Raporti Vjetor i Auditimit (RVA) për Raportin Financiar Vjetor të Buxhetit të Kosovës (RFV/BK) dorëzohet në Kuvendin e Kosovës.

**Auditimet të pajtueshmërisë:** Objektivi i auditimit të pavarur të pajtueshmërisë është t'u ofrojë përdoruesve të synuar informacione për atë nëse entitetet publike të audituara i përmbahen ligjeve, akteve legislative, politikave, udhëzuesve, vendimeve, kodeve të vendosura, standardeve dhe kushteve të dakorduara të kontratave dhe memorandumeve të mirëkuptimit.

Auditimi i pajtueshmërisë përfshinë si aspektet e rregullsisë (respektimi/bindja me kriteret formale siç janë ligjet, rregulloret dhe marrëveshjet përkatëse) dhe/ose konformitetit (respektimi i parimeve të përgjithshme që rregullojnë menaxhimin e shëndoshë financiar dhe sjelljen e zyrtarëve publikë). Pavarësisht nga burimi i kriterëve, auditori kryen auditimin dhe formon një përfundim me nivelin e zgjedhur të sigurisë, në përputhje me kërkesat në ISSAI 400 dhe 4000.<sup>3</sup>

2 "Pajtueshmëri me autoritetet" do të thotë pajtueshmëri me aktet apo rezolutat e legjislaturës apo instrumente tjera statutore, direktiva dhe udhëzues të nxjerra nga organet e sektorit publik me kompetenca të përcaktuara me statut, të cilave pritet t'i përmbahet entiteti i audituara. Thënë ndryshe, është pajtueshmëri me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira.

3 Doracaku i auditimit të pajtueshmërisë (auditimi i pavarur i pajtueshmërisë).

**Auditimet e performancës:** paraqesin një shqyrtim të pavarur, objektiv dhe të besueshëm nëse angazhimet qeveritare, sistemet, operacionet, programet, aktivitetet ose organizatat janë duke vepruar në përputhje me parimet e **ekonomicitetit** (minimizimi i kostove të burimeve), **efikasitetit** (përfitimi sa më shumë nga burimet në dispozicion) dhe **efektivitetit** (përmbushja e objektivave të përcaktuara dhe rezultateve të synuara).

Fushat, objektivat dhe koha e auditimit dhe e raportimit përcaktohen prej rastit në rast, duke u bazuar në rëndësinë, rrezikun, fushëveprimin e auditimit, kapacitetet ekzistuese si dhe kriteret tjera përkatëse.

Auditimi i performancës fokusohet në atë se si organizatat e sektorit publik i kanë përdorur burimet në dispozicion për t'i arritur objektivat e tyre. Për ekzaminimin e performancës së entitetit të audituar, ZKA-ja ndjek një të njëjten nga tri qasjet:

- qasjen e orientuar në **rezultate**, e cila vlerëson nëse janë arritur objektivat e paracaktuara;
- qasjen e orientuar në **problem**, e cila verifikon dhe analizon shkaqet e problemit (ve); ose
- qasjen e orientuar në **sistem**, e cila ekzaminon funksionimin e sistemeve menaxhuese: ose një kombinim të tri qasjeve.


Në kuadër të auditimeve të performancës përfshihen edhe Auditime të TI-së që definohet si ekzaminim dhe rishikim i sistemeve të teknologjisë së informacionit (TI) dhe kontrollet e ndërlidhura me to, për të përfituar siguri ose për të identifikuar rreziqet lidhur me parimet e ligjshmërisë, efikasitetit, ekonomikitetit dhe efektivitetit të sistemeve të TI-së dhe kontrolleve lidhur me këto sisteme.

## 3.2. Procesi i auditimeve

**A. Procesi i auditimeve financiare dhe të pajtueshmërisë** - bazohet në metodologjinë e auditimit të përshkruar në Doracakun e Auditimit Financiar dhe të Pajtueshmërisë (Metodologjia e qasjes së kombinuar) dhe SNISA-t. Auditimi i rregullsisë kryhet nëpër disa hapa duke filluar nga: njohja e entitetit dhe analiza e rreziqeve:

- planifikimi i auditimit;
- ekzekutimi i auditimit;
- dhënia e konkluzioneve dhe opinionit të auditimit;
- raportimi në Kuvend dhe informimi i opinionit publik (publikimi i raporteve); dhe
- përcjellja e adresimit të rekomandimeve të auditimit.

Grafiku 1: Fazat e procesit të auditimit financiar dhe pajtueshmërisë



**Faza 1. Planifikimi i përgjithshëm i auditimit** - Përfshinë gjetjen e sa më shumë informacioneve lidhur me entitetin, i cili po auditohet gjë e cila bëhet në mënyrë më efektive përmes punës përgatitore në zyrën e ZKA-së, një vizite njëditore në terren për ta takuar menaxhmentin e lartë të entitetit.

**Faza 2. Planifikimi i detajuar i auditimit** - Planifikimi i auditimit në hollësi. Bazuar në analizën tonë fillestare, vlerësimin e hollësishëm të rrezikut, dhe vlerësimin e kontrollit të brendshëm, procedurat e mëtutjeshme thelbësore të auditimit duhen të dizajnohen për t'i plotësuar objektivat tona të auditimit. Kjo duhet të përmbledhet në një Memorandum të Planifikimit të Auditimit


**Faza 3. Kryerja e auditimit** - Kryhet ('ekzekutohet') auditimi dhe vlerësohen rezultatet e arritura.

**Faza 4. Raportimi dhe përcjellja** - Formulojmë konkluzionet tona dhe raportojmë për rezultatet e auditimit, si dhe për auditim të Pasqyrave Financiare dhe të pajtueshmërisë me autoritetet, do të rezultojë me opinione /konkluzione zyrtare të auditimit. Zbatimi i rekomandimeve duhet të përcjellët përmes auditimeve pasuese me cilëndo nga procedurat relevante të auditimit, për t'u siguruar që deklaratimet e menaxhmentit lidhur me zbatimin e tyre janë të sakta dhe të drejta.

**B. Procesi i auditimeve të performancës dhe të pajtueshmërisë** - bazohet në metodologjinë e auditimit të përshkruar në Doracakun e Auditimeve të Performancës dhe SNISA-t. Auditimi i performancës dhe ai i pajtueshmërisë kanë qasje të njëjtë dhe kryhet nëpër fazat në vijim:



Grafiku 2: Fazat e procesit të auditimit të performancës



**Faza 1. Planifikimi** - Përfshinë propozimin e temave për auditim dhe përgatitjen e memove parastudimore. Propozimet shqyrtohen përmes një procesi vlerësues lidhur me përshtatshmërinë dhe rëndësinë e temës për t'u audituar. Në këtë fazë po ashtu, ekipet e auditimit bëjnë një hulumtim më të thellë rreth temës përkatëse, ku përcaktohen: problemi i auditimit, objektivat e auditimit, motivi i auditimit, fushëveprimi i auditimit, etj.

**Faza 2. Ekzekutimi i punës në terren** - Ekipet e auditimit pasi që të kenë përgatitur planin detaj të punës fillojnë me kryerjen e punëve audituese në terren dhe të hartojnë draft raportin e auditimit.

**Faza 3. Raportimi** - Ekipi auditues përfundon hartimin e raportit të auditimit, i cili duhet të jetë objektiv, gjithëpërfshirës, i qartë për lexuesin, etj. Pasi që raporti ka kaluar nëpër kontrollin e cilësisë dhe janë dhënë aprovimet e duhura, bën publikimin e tij.

**Faza 4. Përcjellja e auditimit** - Pasi të ketë kaluar një periudhë e përshtatshme kohe, ZKA-ja mund të kryejë një vlerësim të progresit të entitetit të audituar në përgjigjet ndaj gjetjeve të auditimit dhe zbatimit të rekomandimeve dhe të raportoje për to përmes një auditimi përcjellës. Bazuar në standardet e auditimit si dhe në Doracakun për auditime të performancës, auditimet përcjellëse jo domosdoshmërisht kryhen për secilin auditim të kryer paraprakisht. Lidhur me auditimet përcjellëse vendoset në bazë të rëndësisë së temës.

Procesi i auditimit financiar dhe i pajtueshmërisë në ZKA monitorohet dhe rishikohet nga Departamenti për Metodologji dhe Departamenti për Sigurimin e Cilësisë, të cilat kanë përgjegjësi për të siguruar menaxhmentin që auditimet janë kryer duke u bazuar në metodologjinë e aprovuar nga Auditori i Përgjithshëm dhe SNISA-t.

## 4. OBJEKTIVAT E PLANIT VJETOR TË AUDITIMIT

Zyra Kombëtare e Auditimit planifikon punën e audituese në baza vjetore, i cili bazohet në objektivat e Planit Strategjik. Objektivat e ZKA-së për sezonin auditues 2023/24 janë përputhje me kërkesat ligjore që synohet në rritjen e ndikimit në përmirësimin e qeverisjes dhe mundësinë që të shtoj vlerë në menaxhimin e financave publike.

Për sezonin e auditimit 2023/24 janë planifikuar 123 auditime, ku janë paraqitur në Tabelën 1. Plani auditues përfshin të gjitha auditimet e detyrueshme të rregullsisë të përcaktuara me nenin 18.3 të Ligjit të ZKA-së në gjithsej 85 OB dhe 1 RVA, si dhe 8 projekte të financuara nga fondet e jashtme sipas kërkesës, 13 ndërmarrje publike dhe 16 auditime të performancës.

Tabela 1: Numri dhe lloji i auditimeve të planifikuara për sezonin e auditimit 2023/2024

Llojet e auditimit	Numri i auditimeve
<b>Auditime të rregullsisë (financiare dhe të pajtueshmërisë)<sup>4</sup></b>	<b>107</b>
• Buxheti i Kosovës	1
• Institucione të nivelit qendror <sup>5</sup>	47
• Komuna	38
• Ndërmarrje publike <sup>6</sup>	13
• Projekte të financuara nga fondet e jashtme	8
<b>Auditime të performancës<sup>7</sup></b>	<b>16</b>
• Auditime të performancës	6
• Auditime të prokurimit	7
• Auditime të TI-së	3
<b>Gjithsej</b>	<b>123</b>

Të gjitha auditimet janë paraqitur në **Shtojcën 1** të këtij dokumenti.

Raportet individuale për auditimet e rregullsisë (financiare dhe të pajtueshmërisë) do të finalizohen deri më 30 Qershor 2024, si dhe në përputhje me afatin ligjor, Raporti Vjetor i Auditimit për Buxhetin e Kosovës pritet t'i dorëzohet Kuvendit të Kosovës jo më vonë se 31 gusht të vitit 2024.

Auditimet e performancës dhe të projekteve do të publikohen sipas kalendarit kohor të përcaktuar dhe aprovuar nga Auditori i Përgjithshëm.

4 Auditimi i 12 Institucioneve të pavarura dhe 10 komunave do të përkrahen nga kompani private e auditimit.

5 Numri i auditimeve në raport me vitin e kaluar është 5 auditime më i vogël si rezultat i fuzionimit të agjensioneve në ministri, si dhe kryejnë e auditimit të ATK dhe Doganës në kuadër të MFPT.

6 NP dhe RTK.

7 Për temat e zgjedhura të auditimit të performancës, së pari do të kryhen parastudimet dhe pastaj do të vendoset për auditimin e tyre.

Angazhimi i burimeve njerëzore në procese audituese është bërë duke marrë parasysh: disponueshmërinë me burime njerëzore, kualifikimin dhe përvojën e stafit, madhësinë e buxhetit që auditohet, rrezikshmërinë, si dhe kompleksitetin e temës audituese.

#### 4.1. Objektivi i auditimeve të rregullsisë

Për dallim nga sezoni i kaluar, përveç auditimeve të rregullta vjetore, menaxhmenti i ZKA-së ka vendosur që në planin vjetor të auditimit të përfshijnë edhe auditimin financiar dhe pajtueshmërisë për NP: Trepça Sh.A, KOSTT dhe Hidrodrini SH.A.

Trepça Sh.A. është Ndërmarrje Publike Qendrore në pronësi të Qeverisë së Kosovës me 80% të aksioneve dhe 20% të tjera ju takon punëtorëve të Trepçës. Mos auditimi i sajë nga ZKA për vite të tëra, si dhe ndikimi dhe pesha e këtij resursi pasuror për Kosovën në zhvillimin e gjithmbarshëm ekonomik të vendit, gjenerimin e punësimit, rritjen e eksportit dhe BPV.

KOSTT SH.A. është Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të energjisë elektrike të Kosovës, kompani publike me 100 % të aksioneve shtetërore. Sipas Ligjit për energjinë elektrike nr.05/L-085 të miratuar në vitin 2016, të drejtat e aksionarit ushtrohen përmes Kuvendit të Republikës së Kosovës.

“Hidrodrini” Sh.A. është institucion publik profesional i licencuar nga Autoriteti Rregullator për Shërbime të Ujit, për ofrimin e shërbimeve baze, të furnizimit me ujë të pijshëm dhe shërbimet e kanalizimit.

Këto NP Zyra Kombëtare e Auditimit do t'i auditojë në aspektin financiar dhe të pajtueshmërisë.

Ndërsa, duhet të theksohet se në krahasim me vitin e kaluar kemi rritur kontraktimin e Institucioneve të Pavarura prej 11 sa ishin, tani janë 12 të kontraktuara, po ashtu rritje ka edhe tek komunat prej 6 sa ishin tani janë 10 të kontraktuara) Kjo ka ndodh për shkak të mungesës së stafit, dhe fenomenit që po e përcjell ZKA-në dorëheqjet nga puna të profesionistëve, kryesisht për shkak të pagave jo të konkurrueshme për këtë profesion.

Gjithsej, auditimi i 12 institucioneve të pavarura dhe 10 komunave do të përkrahet nga kompani private e auditimit, përderisa, monitorimi i tyre dhe opinioni i auditimit përcaktohet nga Auditori i Përgjithshëm bazuar në metodologjinë e ZKA-së dhe SNISA-ve.

Për sezonin auditues 2023/24, ZKA-ja ka planifikuar auditimin e rregullsisë në 85 OB (financiar dhe të pajtueshmërisë pa përfshirjen e RVA-së), 13 auditime të NP, si dhe 8 projekte të financuara nga Banka Botërore.

Vlen të theksohet se ZKA ka krijuar mekanizma të brendshëm në trajtimin e kërkesave të ndryshme që vijnë nga palët e jashtme për auditime me kërkesë, dhe si të tilla janë trajtuar në mënyrën efektive.

**Mënyra e përzgjedhjes së auditimeve të rregullsisë:** Përveç auditimeve të detyrueshme të rregullsisë të përcaktuar me ligj, fokus i veçantë i është dhënë auditimeve në institucioneve publike dhe ndërmarrjeve publike të cilat nuk ishin audituar një kohë të gjatë nga auditimi shtetërorë siç janë: Trepça, KEK, KOSTT, RTK dhe projekte kapitale me peshë të lartë financiare për të siguruar auditime efikase të bazuar në rrezik.

Fushëveprimi i auditimit apo qasja e auditimit nuk do të ndryshojë nga vitet paraprake, por do të ketë fokus më të madh në fushat që mund të pritet apo vlerësohet që mund të jenë më me rrezik dhe të kenë ndonjë shmangie nga rregullativa ligjore.

Planifikimi i auditimit është pjesë shumë e rëndësishme e procesit të auditimit për arsye se i jep drejtim auditimit, duke u bazuar në një vlerësim të rreziqeve që kanë të bëjnë me entitetin, prandaj një auditim efektiv dhe efikas mbështetet mbi planifikimin në mënyrën e duhur të proceseve dhe procedurave.

Ne kemi zhvilluar një strategji dhe qasje të detajuar për punën specifike në mënyrë që auditimi të kryhet në mënyre efikase dhe në kohën e duhur. Qëllimi ynë është që të bëhet i sigurt fakti se çështjeve të auditimit iu kushtohet rëndësia e duhur dhe çështjet problematike identifikohen dhe trajtohen siç duhet brenda mandatit kushtetues dhe ligjor. Do të kemi parasysh dhe do të bëjmë një përshkrim të natyrës, kohëzgjatjes dhe shtrirjes së procedurave të nevojshme të auditimit. Të njihet entiteti dhe mjedisi ku vepron, përfshirë këtu kontrollet e brendshme, aq mjaftueshëm sa të jetë në gjendje të identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalive materiale të pasqyrave financiare, qofshin ato si rrjedhojë e mashtrimeve ose gabimeve, dhe aq mjaftueshëm sa të jemi të aftë të krijojmë dhe kryejmë procedurat e mëtejshme të auditimit.

## 4.2. Rreziqet e auditimit

Për auditimet financiare dhe të pajtueshmërisë, para përgatitjes së planit auditues vlerësohen rreziqet për të gjitha institucionet. Si pjesë e punës për zhvillimin e planit vjetor të auditimit, ne shqyrtojmë edhe rreziqet potenciale sinjifikante. Rreziqet sinjifikante janë rreziqe të vlerësuara të anomalive materiale sipas gjykimit të auditorëve, kërkojnë vëmendje të veçantë të auditimit që kanë rezultuar gjatë proceseve individuale të auditimit në OB dhe janë evidentuar në RVA. Ne këtë sezonë audituese përveç çështjeve tjera, vëmendje do i kushtohet;

- Keq klasifikimit të shpenzimeve nëpër OB, si dhe
- Menaxhimit të pasurive financiare.

Sipas Rregullës financiare nr. 01/2013-Shpenzimi i parave publike, shpenzimet duhet të jenë në kode adekuate, të përcaktuara me planin kontabël. Po ashtu, UA 19/2009 për planin kontabël kërkon nga ZKA dhe ZKF që të sigurojnë që të gjitha transaksionet janë regjistruar në SIMFK sipas strukturës së planit kontabël dhe klasifikimeve të përcaktuara me këtë UA.

Po ashtu, Rregullorja MF nr. 02/2013 mbi Menaxhimin e Pasurive në Organizata Buxhetore i obligon të gjitha organizatat të mbajnë regjistrat e pasurisë jo financiare që ka në menaxhimin e saj. Vazhdimisht të bëjnë azhurnimin e tyre, varësisht nga blerjet/përvetësimet e reja apo shqyrtimit sistematik të gjendjes së tyre të përdorimit.

## Përgjigja e Auditimit

Ne do të kemi fokus të veçantë ndaj këtyre rreziqeve. Si përgjigje ndaj këtyre rreziqeve do të bëjmë punë shtesë duke dizajnuar një program të veçantë të auditimit për klasifikimin e shpenzimeve dhe menaxhimin e pasurive.

Ne do të shqyrtojmë sistemet tjera të kontabilitetit dhe kontrollet e menaxhmentit vetëm aq sa ne e konsiderojmë të nevojshme për të kryer një auditim efektiv. Si rezultat, shqyrtimi jonë mund të mos zbulojë të gjitha mangësitë apo të gjitha përmirësimet që mund të bëhen. Aty ku ne zbulojmë çfarëdo mangësie apo dobësie të rëndësishme, ne do ti raportojmë me rekomandime për përmirësim.

Në planin vjetor të auditimit, për institucionet e mëdha dhe komplekse, fokusi bëhet tek shpërndarja e stafit sipas kualifikimeve, përvojës dhe kompetencës profesionale.

Me qëllim të mbulimit të auditimeve mandatore krahas burimeve njerëzore, të cilat nuk mund ti mbulojmë me stafin e rregullt, ZKA bën vlerësimin e rreziqeve për auditimet, ashtu që auditimet me më pak rreziqe kontraktohen nga kompani private të licencuara të auditimit.

### 4.3. Objektivi i auditimeve të performancës, prokurim, IT

Zyra Kombëtare e Auditimit, në planin e saj vjetor vazhdon t'i japë rëndësi të veçantë auditimeve të performancës, prokurimit dhe të TI-së. Për sezonin auditues 2023-2024 do të mbulohen fusha me rëndësi ekonomike, infrastrukturë, sociale, shëndetësi, media, kulturë e sport si dhe tema të rëndësishme në fushën e prokurimit publik dhe projekteve nga donatorë, si dhe janë planifikuar auditime të sistemeve të informacionit.

**Mënyra e përzgjedhjes së auditimeve të performancës** - Me qëllim të maksimizimit të burimeve dhe rritjes së ndikimit përmes këtyre auditimeve në mirëqenien e qytetarëve, ZKA zhvillon një proces të përzgjedhjes së fushave/temave të auditimit. Fillimisht identifikohen fushat kryesore, pastaj bëhet një analizë brenda zyrës përfshirë rezultatet nga raportet e auditimit të rregullsisë apo pajtueshmërisë për identifikimin e mangësive kyçe si dhe ftohen auditorët të propozojnë tema bazuar në njohuritë e tyre dhe problematikat e hasura gjatë auditimeve paraprake.

Për më shumë, zhvillohet komunikim dhe diskutim me palët e jashtme të interesit, organizohet tryezë e përbashkët me Shoqërinë Civile si OJQ, organizata profesionale, komuniteti i donatorëve dhe ekspertë të fushave, për diskutimin e temave duke i'u dhënë mundësinë pjesëmarrësve për ofrimin e propozimeve. Si rrjedhojë, finalizohet plani vjetor në të cilin përfshihen tema të propozuara nga shoqëria civile, me kërkesë nga Kuvendi i Kosovës, si dhe projekte të donatorëve.

Përmes këtyre auditimeve, ZKA synon të promovojë efikasitetin, llogaridhënien, efektivitetin dhe transparencën e administratës publike.

Po ashtu gjatë përzgjedhjes së fushave që do të mbulohen me auditimet e performancës, prokurimit dhe TI-së janë marrë parasysh edhe qëllimet e Agjendës së Kombeve të Bashkuara për zhvillim të vazhdueshëm 2030 si dhe aktivitetet e Qeverisë lidhur me këto objektiva.

**Qëllimi: Mbrojnë, rivendosin dhe promovojnë përdorimin e qëndrueshëm të ekosistemeve tokësore, menaxhojnë në mënyrë të qëndrueshme pyjet, luftojnë shkatërrimin dhe degradimin e tokës.**

**Menaxhimi i tokave/pronës nga Instituti Bujqësor i Kosovës:** Instituti Bujqësor të Kosovës është Institut për Hulumtime Shkencore në Bujqësi më seli në Pejë dhe është në kuadër të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural. Më Vendim të themelimit, Institutit i janë ndarë hapësirë e konsiderueshme e tokës bujqësore në zona të ndryshme kadastrale të cilat menaxhohen nga Instituti.

Të hyrat nga qiraja nga objektet publike dhe pronat për periudhën 2012-2022 nga DFSHP dhe IBK janë në vlerë prej 830,053€. Tokat bujqësore duhet shfrytëzohen vetëm për prodhimtari bujqësore dhe përjashtimisht mund të shfrytëzohet edhe për qëllime të tjera vetëm në rastet e përcaktuara me Ligj.

Qëllimi i këtij auditimi është menaxhimi i tokave/objekteve nga IBK dhe vlerësimi i procesit të dhënies se tokës/objekteve me qira.

### **Qëllimi: Arritja e barazisë gjinore dhe fuqizimi i grave dhe vajzave**

**Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave nga zonat rurale përmes përfshirjes së tyre në tregun e punës:** Megjithëse në Kosovë korniza ligjore është mjaft e avancuar për të siguruar dhe garantuar barazi gjinore, barazia gjinore ende mbetet një standard i pa arritur ku gratë janë të nën përfaqësuar në shumë sfera të shoqërisë si vendimmarrje, punësim dhe sfera tjera shoqërore. Pjesëmarrja e grave në tregun e punës vazhdon të mbetet më e ulëta në krahasim me vendet e tjera të rajonit.

Qëllimi i këtij auditimi është që të vlerësojmë efektivitetin dhe ndikimin e politikave, programeve dhe masave që synojnë promovimin e përfshirjes së grave nga zonat rurale në tregun e punës.

### **Qëllimi: Qytetet dhe vendbanimet të jenë gjithëpërfshirëse, të sigurt dhe të qëndrueshme për qytetarët**

**Problemet me menaxhimin e parkingjeve të veturave në Komunën e Prishtinës nga "Prishtina Parking":** Ndërmarrja Publike «Prishtina Parking» ka filluar me implementimin, menaxhimin dhe mirëmbajtjen e parkingjeve në Komunën e Prishtinës për të përmbushur nevojat e qytetarëve sa i përket parkimit të veturave. Megjithatë, në vazhdimësi janë evidentuar probleme me menaxhimin e parkingjeve nga kjo ndërmarrje duke shkaktuar ankesa të shumta nga qytetarët dhe banorët e zonave ku ka filluar implementimi i projektit.

Qëllimi i këtij auditimi është të vlerësojmë procesin e implementimit dhe menaxhimin e parkingjeve në komunën e Prishtinës dhe aktivitetet e ndërmarrjes në lidhje me parkingjet.

### **Qëllimi: Sigurimi i jetëve të shëndetshme dhe promovimi i mirëqenies për të gjitha moshat**

**Lista e pritjes së pacienteve:** Shëndetësia ka rol të rëndësishëm në jetën e secilit qytetar. Për të ofruar shërbime mjekësore adekuate dhe në kohë institucionet përgjegjëse duhet të sigurojnë infrastrukturën fizike dhe staf profesional. Shërbimet mjekësore që ofrohen nga institucionet shëndetësore publike vazhdojnë të kenë sfida e që kjo ndikon në krijimin e listave të gjata të pritjes për qytetarët që drejtohen për trajtim në spitale publike. Për shkak të mos mirëmbajtjes dhe menaxhimit të pajisjeve si CT, MRI, etj, pacientët nuk mund të marrin shërbimet e nevojshme. Qëllimi i këtij auditimi do të jetë të vlerësojmë mënyrën e menaxhimit të listave të pritjes së pacientëve në institucionet shëndetësore publike dhe ndikimi i saj në rrezikun e shëndetit të pacientëve.

**Sponsorizimi i sportit:** Sporti është komponentë i rëndësishëm i zhvillimit socio-ekonomik të një vendi. Pjesëmarrja aktive në sport përmirëson shëndetin dhe produktivitetin e komunitetit, zvogëlon shpenzimet mjekësore, gjeneron liderë të mëdhenj dhe rrit kohezionin social. Sipas ligjit për sponsorizim e sportit të dekretuar në vitin 2017, parashihet se bizneset kanë mundësi të financojnë aktivitetet sportive për interes të përgjithshëm për përmirësimin e jetesës së qytetarit, në anën tjetër bizneset që financojnë aktivitetet e sportit i lejohet zbritja deri në shumën 30% të tatimit në fitim. Shoqëria civile ka propozuar këtë temë për shkak të dyshimeve lidhur me financimin e tyre nga ana e bizneseve dhe se klubet sportive dhe bizneset nuk përmbushin kërkesat e parapara në ligj. Bazuar në vlerësimet e bëra ZKA e konsideron si temë me rëndësi për auditim. Në raportet financiare të ZKA-së është raportuar për parregullsi të ndryshme në këtë fushë, si: mos raportim të saktë nga ana e federatave të sportit, mos arsyetim të projekteve me kohë dhe sipas rregullores, arsyetim i dobët i shpenzimeve nga ana e federatave etj. Qëllimi i këtij auditimi do të jetë të vlerësojmë se sa kanë arritur federatat dhe klubet e sportit në Kosovë ti plotësojnë objektivat e tyre të financuara nga ana e bizneseve dhe ministrisë përkatëse.

**Licencimi i mediave:** Mediat, si burim kryesor i informacionit, kanë një rol shumë të rëndësishëm në shoqërinë tonë duke ndikuar në opinionin publik dhe në zhvillimin e kulturës dhe identitetit. Institucioni përgjegjës në vendin tonë për licencimin e mediave është Komisioni i Pavarur i Mediave (tutje KPM) i cili siguron se të gjitha kompanitë që ofrojnë shërbime mediatike janë të pajisur me licencat e nevojshme dhe këto licenca janë në përputhje me kriteret ligjore. Obligimet nga tarifa për licencë dhe gjobat të cilat e kanë statusin e të arkëtueshme në vlerë prej 795,970 euro, të cilat nuk janë paguar nga ofruesit e shërbimeve mediatike ndaj KPM-së përgjatë viteve janë si pasojë e mos pagesave të obligimeve për pagesën e tarifës së licencës, kamatës dhe gjobave. Qëllimi i këtij auditimi është të vlerësojmë proceset dhe procedurat e KPM-së në lidhje me licencimin e mediave, mbledhjen e tarifave të licencës dhe gjobat nga mediat. Po ashtu, të identifikohen arsyet e vështirësive me të cilat ballafaqohet KPM-ja në rilicensimin e mediave dhe mbledhjen e fondeve, veçanërisht për shkak të mos përmbushjes së detyrimeve financiare.

### **Qëllimi: Industria, inovacioni dhe infrastruktura**

**Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës Infracos - Auditimi i projektit për rehabilitimin e linjës 10 Hani i Elezit-Leshak:** Qeveria e Republikës së Kosovës ka nënshkruar marrëveshje me EU WBIF Grant, EBRO dhe EIB për bashkëfinancimin e projektit për Rehabilitimin e Linjës 10 Hani i Elezit- Leshak - Faza I (Hani i Elezit- Fushë Kosovë) dhe Faza II (Fushë Kosovë - Mitrovicë) ku vetëm pjesa ndërtimore e infrastrukturës është në vlerë prej 126.6 milion euro. Përfitues i këtij projekti është Infracos e cila NP ngarkohet me kthimin e mjeteve së bashku me interesin kreditor.

Realizimi i Projektit për Rehabilitimin e Linjës 10 Hani i Elezit – Leshak, ka ngecje që ndikojnë në Infracos dhe në transportin hekurudhor në përgjithësi si dhe kompanive që ndërlidhen me këtë transport. Po ashtu ka indikacione të devijimeve të projektit krahas kushteve kontraktuale fillestare të projektit.

Qëllim i auditimit është vlerësimi i realizimit përkatësisht implementimit të këtij projekti.

**Menaxhimi i sektorit të ndërtimeve në Kosovë:** Zhvillimi i hovshëm i sektorit të ndërtimit në Kosovën e pasluftës është përcjellë me mangësi të shumta. Marrja e lejeve të ndërtimit konsiderohet si burokratikë e në anën tjetër dhënia e lejeve të ndërtimit dhe kontrolli i ndërtimeve konsiderohet si çështje kritike dhe sfidë për institucionet publike dhe jetën e qytetarëve. Për këtë arsye edhe ZKA e vlerëson me prioritet të lartë.

Qëllimi i këtij auditimi është vlerësimi i procesit të menaxhimit të lejeve ndërtimore dhe ndikimin që e ka në infrastrukturën publike si dhe pranimet teknike të objekteve të banimit.

### **Qëllimi: Shëndeti dhe mirëqenia**

**Kontratat e Institucioneve Publike të Republikës së Kosovës me organizatën Caritas Kosova:** Organizatat e nivelit qendror dhe lokal, për të përmbushur objektivat e tyre për të iu ofruar shërbime shëndetësore qytetarëve të Kosovës, kanë përzgjedhur që një pjesë të këtyre shërbimeve ta bëjnë përmes Caritas Kosova, kështu duke lidhur marrëveshje, duke zhvilluar procedura të prokurimit publik apo edhe me thirrje publike.

Për probleme të ndryshme që kanë përcjellë këto kontrata kanë raportuar ZKA, OJQ-të dhe mediat.

Qëllimi i këtij auditimi është që të vlerësoj se si janë zhvilluar procedurat për të kontraktuar këto shërbime, nëse menaxhimi i këtyre kontratave është bërë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe nëse janë arritur rezultatet e synuara.

### **Qëllimi: Qytete dhe komunitete të qëndrueshme**

**Efektiviteti i mekanizmave të sigurimit të cilësisë së të dhënave të raportuara për SMPK dhe GPK:** Bashkëpunimi mes ZKA-së dhe Demos ka filluar nga viti 2019 kur është nënshkruar kontrata e parë lidhur me auditimin e Granatit të Performancës Komunale, dhe ka vazhduar tutje edhe viteve të tjera. Kjo është hera e pestë që DEMOS kërkon nga ZKA që të auditoj dhe fokusi kësaj here është në procesin e funksionimit të mekanizmave të kontrollit në sigurimin e cilësisë së të dhënave.

Qëllimi i këtij auditimi është të vlerësojmë funksionimin e mekanizmave të kontrollit në sigurimin e cilësisë së të dhënave dhe vlerësimin e raportuar në Sistemin e Menaxhimit të Performancës Komunale (SMPK) dhe Grantin e Performancës Komunale (GPK).

### **Dokumentimi dhe verifikimi i performancës komunale për vitin 2020:**

Sistemi i Menaxhimit të Performancës Komunale SMPK përbehet nga 19 fusha. Këto fusha përfshijnë 119 tregues, të cilët e matin performancën e komunave. SMPK plotësohet nga koordinatoret dhe zyrtarët përgjegjës të emëruar nga kryetarët e komunave dhe monitorohet nga zyrtarët e MAPL-së.

Vlerësimi për GPK bëhet për tri fusha kryesore të cilat ndahen në 10 nën-fusha ndërsa numri i treguesve është 30 prej të cilëve 28 janë vlerësuar nga grupi teknik dhe komisioni i GPK. Grupet e vlerësimit të GPK-së janë në përbërje nga përfaqësues të MAPL-së, zyrtarët publik nga ministrinë relevante, donatorët dhe shoqëria civile.

Qëllimi i këtij auditimi është vlerësimi i procesit të raportimit dhe vlerësimit të performancës komunale.

**Shitje direkte - AKP:** AKP-ja krijon Ndërmarrje të Reja nga Ndërmarrjet Shoqërore duke ofruar për shitje asetet dhe obligimet aktuale të NSh-ve (të përcaktuara për tre muajt e fundit të llogarive të pagueshme të papaguara dhe vitin e fundit të TVSh-së së papaguar). Në këtë mënyrë mundësohet investimi në asetet kyçe, ndërsa obligimet e NSh-së trajtohen gjatë procesit të Likuidimit.



Me krijimin e Ndërmarrjeve të reja, investitorët paraqesin ofertë vetëm për asetet e caktuara – dhe vetëm për një numër të kufizuar të detyrimeve aktuale – të NSh-së dhe nuk paraqesin oferta për vetë NSh-në si tërësi.

Për periudhën 2006-2023 vlera e shitjeve direkte nga AKP kap vlerën prej 41,483,732 euro. Shitja me vlerën më të madhe është një fabrikë në vlerë prej 30,100,000 euro e që përbën 73% të vlerës totale të shitjeve të AKP deri më tani. Pas kësaj, shitja e tokave bujqësore përbën 6,039,468 euro derisa pason shitja e tokave ndërtimore në vlerë prej 4,566,477 euro. Shitjet tjera për periudhën (2006-2023) kapin vlerën prej 771,000 eurove e që përfshijnë shitje të tokave komerciale, shtëpive a ndërtesave administrative si dhe asetëve të luajtshme.

Qëllimi i këtij auditimi është që të vlerësohet nëse AKP ka qenë efektive në menaxhimin e procesit të shitjeve direkte.

Ky auditim vjen si kërkesë nga Kuvendi i Kosovës dhe si rezultat i auditimit të performancës për të hyrat nga qiraja i zhvilluar në sezonin e mëparshëm.

### **Qëllimi: Forcimi i mjeteve të zbatimit dhe rigjallërimi i Partneritetit Global për Zhvillim të Qëndrueshëm, pjesa e teknologjisë**

**Teknologjia e Informacionit (TI):** Auditimet e TI-së po ashtu kontribuojnë në disa nga Qëllimet e vendosura në agjendën për zhvillim. Me rritjen e aplikimit të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit është rritur edhe rëndësia dhe nevoja e auditimeve të TI-së. Këto auditime janë një ekzaminim dhe rishikim i sistemeve të teknologjisë së informacionit dhe kontrolleve përkatëse për të pasur siguri mbi parimet e ligjshmërisë, efikasitetit, ekonomisë, dhe efektivitetit të sistemeve të informacionit. ZKA i ka kushtuar rëndësi të veçantë auditimeve të teknologjisë së informacionit pasi në përgjithësi ka dobësi në këtë fushë dhe institucionet përgjegjëse kanë nevojë për përmirësime në qeverisjen dhe sigurinë e sistemeve të informacionit si dhe në efikasitetin e përdorimit dhe menaxhimit të këtyre sistemeve.

Për sezonin auditues 2023/2024 janë planifikuar tri (3) auditime në fushën e teknologjisë së informacionit, "Sistemit i Menaxhimit të Stokut Farmaceutik", "Modernizimi i Sistemit të Edukimit në Kosovë përmes e-Edukimit" dhe "Sistemi i Doganave të Kosovës - ASYCUDA World", ky i fundi në kuadër të projektit LOTA të IDI-Iniciativa për Zhvillim e INTOSAI.

Qëllimi e këtyre auditimeve është zhvillimi dhe menaxhimi i projekteve/sistemeve të TIK, vlerësimi i kontrolleve të aplikacionit, siguria e informacionit, integriteti dhe disponueshmëria e të dhënave.

**Sistemit i Menaxhimit të Stokut Farmaceutik (SMSF):** Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës ka funksionalizuar Sistemin e Menaxhimit të Stokut Farmaceutik (SMSF), përmes së cilit Barnatorja Qendrore, Barnatoret e Klinikave dhe Barnatoret e Reparteve regjistrojnë planifikimin e barnave, kërkesat, porositë, stokun, daljet për pacientë si dhe shërbime tjera përfshirë kartelat e ilaçeve, raportet etj. Ky sistem mundëson që ilaçet të monitorohen në mënyrë elektronike që nga momenti i daljes nga Barnatorja Qendrore e deri tek shfrytëzuesi i fundit-pacienti.

Mirëpo është sfidë regjistrimi i numrit të mirëfilltë të përshkrimeve të barërave dhe shpërndarja e barnave deri tek pacienti dhe shfrytëzimi i tyre. Po ashtu ky sistem nuk është i ndërlidhur me sistemin informativ shëndetësor (SISh) dhe shpërndarja e barnave deri tek pacienti nuk identifikohet.

Qëllimi i këtij auditimi është vlerësimi i administrimit të SMSF-së dhe sigurisë së informacionit, përkatësisht integritetit dhe disponueshmërisë së të dhënave.

#### **Modernizimi i Sistemit të Edukimit në Kosovë përmes e-Edukimit:**

Projekti «Modernizimi i Sistemit të Edukimit në Kosovë përmes E-edukimit» ka për synim të përdorë teknologjinë e informacionit dhe komunikimit (TIK) për të përmirësuar cilësinë e arsimit dhe ofertës arsimore në Kosovë. Po ashtu ka për qëllim të përfshijë zhvillimin e platformave të mësimi të mbështetur nga teknologjia, trajnimin e mësuesve për përdorimin e TIK-ut në mësimdhënie, krijimin e materialeve të mësimi në formatin e elektronikës, dhe shumë më tepër. Projekti rrjedh nga një marrëveshje kredie ndërkombëtare dhe përfundimi i projektit është parashikuar në vitin 2017. Mirëpo sipas informacioneve preliminare projekti ende nuk është funksionalizuar, sidomos pjesa e programit e-Matura. Lidhur me këtë projekt ka edhe implikime financiare pasi shpenzimet e paguara për interesat janë 50,000€ në vit.

Qëllimi i këtij auditimi është të vlerësohet nëse Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë ka menaxhuar si duhet resurset dhe proceset e zhvillimit të sistemit të informacionit «e-Edukimi» dhe ka zbatuar këtë sistem, për të arritur përmbushjen e qëllimit për digjitalizimin e proceseve arsimore.

**Sistemi i Doganave të Kosovës - ASYCUDA World:** Sistemi ASYCUDA World është sistem i krijuar në Gusht të vitit 2011, ndërsa është futur në funksion në Shtator 2012. Ky sistem është zhvilluar nga Konferenca e Kombeve të Bashkuara për Tregti dhe Zhvillim (UNCTAD), në Gjenevë.

Roli kryesor i këtij sistemi është menaxhimi i procedurave doganore për zhdoganimin e mallrave si dhe menaxhon të gjitha llojet e detyrimeve doganore, mbi 1.5 miliardë eurove që mbliidhen nga Dogana e Kosovës – DK në baza vjetore.

Objektiv i këtij auditimi do të jetë vlerësimi i administrimit të ASYCUDA World dhe sigurisë së informacionit, përkatësisht integritetit dhe disponueshmërisë së të dhënave.

## 5. BUXHETI DHE BURIMET NJERËZORE

ZKA-ja është institucion i pavarur, i cili financohet nga Buxheti i Republikës së Kosovës i cili miratohet nga Kuvendi i Kosovës, sipas procedurës së përcaktuar me Ligjin 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë. Buxheti menaxhohet dhe shpenzohet me një përgjegjësi dhe llogaridhënie të lartë.

Bazuar në Ligjin e Buxhetit për vitin 2023, mjetet e ndara për ZKA-në janë 3,266,591€. Krahasuar me Ligjin mbi Ndarjet Buxhetore për vitin 2022, buxheti për vitin 2023 shënon një rritje rreth 6.5%. Buxheti është i ndarë në katër kategori ekonomike: Paga dhe mëditje, Mallra dhe shërbime, Shërbime komunale dhe Investime kapitale.

ZKA me buxhetin vjetor ka të miratuar 180 vende pune, mirëpo aktualisht ka të punësuar 163 punonjës. Numri prej 130 punonjëseve janë të angazhuar drejtpërdrejt në auditim, kurse pjesa tjetër në shërbimet tjera menaxheriale, administrative dhe mbështetëse.

Për të arritur qëllimet dhe objektivat strategjike, ZKA-ja është duke investuar në zhvillimin e vazhdueshëm profesional të burimeve njerëzore. Punonjësve auditues do t'iu mundësohet vijimi i trajnimeve dhe arritja e normativit të përcaktuar me SNISA-t për arsimin e vazhdueshëm profesional, si një nga faktorët themelor për kryerjen e auditimeve me kompetencë, cilësi dhe sipas kërkesave të SNISA-ve.

Bazuar në kërkesat për auditime dhe rritjes së portofolit të auditimeve nuk janë të mjaftueshëm numri i auditorëve për të mbuluar gjithë këto auditime. Kjo e vështirëson përmbushjen e objektivave institucionale për përfshirjen e të gjitha organizatave buxhetore në auditimin financiar dhe të pajtueshmërisë, pastaj përfshirjen në auditimin e rregullsisë të më shumë ndërmarrjeve publike si dhe rritjen e numrit të auditimeve të performancës.

Në mungesë të burimeve të mjaftueshme, ZKA-ja është e detyruar për çdo vit të kontraktoj kompani private të auditimit për të përkrahur auditimin e një numri të caktuar të organizatave buxhetore të detyruar me ligj për auditime financiare.


## 6. ZBATIMI I PLANIT VJETOR

Plani vjetor i auditimit do të zbatohet nga 1 shtatori 2023 deri më 31 gusht 2024.

Për zbatimin e aktiviteteve të planifikuara në këtë plan, ZKA-ja përgatit plane operative audituese, sipas fushave, organizatave buxhetore dhe projekteve të caktuara, shumave të buxhetit, si dhe përbërjen e stafit për realizimin e planit në këtë sezonë audituese, duke u mbështetur nga sistemi informativ i teknologjisë së kryerjes së auditimit-SITA. Mbi këtë bazë, ZKA përgatit edhe planin kohor për përfundimin e sezonit auditues për secilin projekt auditues i cili inkorporohet në SITA dhe monitorohet në vazhdimësi realizimi i tij.

Prishtinë, Tetor 2023

**Vlora Spanca**  
Auditore e Përgjithshme



## Shtojca 1. Subjektet/temat dhe shuma e buxhetit që do të auditohet.

### A: AUDITIMET FINANCIARE DHE TË PAJTUESHMERISË

Tabela 1.

Institucione të nivelit qendror/RVA [1 + 47 = 48]

Entitetet nën auditim		Buxheti 2023
1	Auditimi i Raportit Vjetor të Buxhetit të Republikës së Kosovës	3,211,603,100
1	Kuvendi i Kosovës	10,859,441
2	Zyra e Presidentit	3,803,568
3	Zyra e Kryeministrit	21,986,762
4	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (Dogana e Kosovës dhe Administrata Tatimore e Kosovës)	1,111,170,611
5	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	9,691,668
6	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	86,710,224
7	Ministria e Tregtisë, Ndërmarrësisë dhe Industrisë	39,827,685
8	Ministria e Ekonomisë	52,850,827
9	Ministria e Shëndetësisë	81,006,877
10	Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës	139,665,909
11	Fondi i Sigurimeve Shëndetësore	8,938,806
12	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve	57,017,862
13	Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Teknologjisë	82,799,243
14	Universiteti i Prishtinës	32,666,582
15	Ministria e Komuniteteve dhe Kthimit	4,393,340
16	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës	251,684,838
17	Ministria e Punëve të Brendshme	179,768,259
18	Ministria e Drejtësisë	46,042,568
19	Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës	35,945,052
20	Ministria e Mbrojtjes	123,227,261
21	Ministria e Zhvillimit Rajonal	5,277,788
22	Këshilli Prokurorial i Kosovës	15,913,983
23	Komisioni i Pavarur i Minierave dhe Mineraleve	1,499,088
24	Këshilli Gjygjësor i Kosovës	34,155,572
25	Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik*	866,200

26	Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës*	1,196,159
27	Autoriteti i Rregullator i Komunikimeve Elektronike dhe Postare	1,500,221
28	Agjencioni Kundër-Korrupsion*	557,844
29	Zyra Rregullatorit për Energji	799,856
30	Organi Shqyrtues i Prokurimit*	419,631
31	Gjykata Kushtetuese e Kosovës	2,107,861
32	Autoriteti Kosovar i Konkurrencës*	393,868
33	Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturorë*	230,532
34	Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashesa	207,742
35	Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës*	374,714
36	Autoriteti Rregullativ i Shërbimeve të Ujit*	399,835
37	Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave	353,332
38	Autoriteti i Aviacionit Civil	922,281
39	Komisioni i Pavarur i Mediave*	881,348
40	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	6,397,741
41	Institucioni i Avokatit të Popullit	1,296,704
42	Akademia e Drejtësisë*	892,367
43	Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës	2,574,368
44	Agjensioni për Informim dhe Privatësi*	418,637
45	Fondet në Mirëbesim	-
46	Agjencioni Kosovar i Privatizimit	5,698,956
47	Agjencioni për Shërbimet e Navigimit Ajror	7,232,550

\*Institucionet e Pavarura, auditimi i së cilave do të përkrahet nga kompania private e auditimit.

**Komuna [38]**

Entitetet nën auditim		Buxheti 2023
1	Prishtinë	106,388,981
2	Obiliq	12,921,229
3	Podujevë	27,406,567
4	Fushë Kosovë	15,093,936
5	Mitrovica e Jugut	25,011,350
6	Graçanicë	8,767,352
7	Mitrovica e Veriut*	5,979,551
8	Zubin Potok*	3,032,542
9	Zveçan*	2,737,405
10	Prizren	57,491,944
11	Mamushë*	2,276,221
12	Malishevë	18,124,837
13	Rahovec	17,548,240
14	Lipjan	19,779,849
15	Shtime	8,756,040
16	Suharekë	19,807,625
17	Shtërpçë	4,184,093
18	Kllokot*	1,282,328
19	Gjilan	32,599,281
20	Viti	14,996,356
21	Novobërdë	3,329,628
22	Ferizaj	38,103,752
23	Klinë	13,051,595
24	Pejë	33,290,700
25	Istog	13,051,471
26	Glllogoc	18,156,892
27	Skenderaj	16,291,891
28	Vushtrri	23,373,910
29	Gjakovë	31,558,422
30	Deçan	12,119,805
31	Dragash*	10,871,961
32	Junik*	1,877,346
33	Kamenicë	12,381,899
34	Leposaviq*	5,476,871
35	Partesh*	1,363,064
36	Ranillug	1,790,463
37	Kaçanik	10,674,689
38	Hani i Elezit*	3,349,715

\*Institucionet lokale, auditimi i së cilave do të përkrahët nga kompania private e auditimit.

**Ndërmarrje publike [12]**

Entitetet nën auditim	
1	Korporata Energjetike e Kosovës, sh.a (KEK)
2	Hekurudhat e Kosovës - InfraKos, sh.a
3	Trepça Sh.A
4	KRU "Prishtina" sh.a - Prishtinë
5	Ndërmarrja Publike Banesore - Prishtinë
6	Telekomi i Kosovës
7	KOSTT
8	KRM "Pastrimi", sh. a - Prishtinë
9	KRM "Uniteti" sh.a - Mitrovicë
10	Ngrohtorja Qendrore "Termokos" - Prishtinë
11	NPH "Ibër - Lepenc" sh.a - Prishtinë
12	Hidrodrini sh.a -Pejë

**Organizatat tjera buxhetore [1]**

1. Radio Televizioni i Kosovës

**Projekte që financohen nga huamarrja shtetërore dhe nga donatorët [8]**

Entitetet nën auditim	
1	Konkurrueshmëria dhe gatishmëria për eksport (MINT-BB)
2	Efiçienca e Energjisë së ripërtritshme -konsolidim(ME - BB)
3	Ekonomia Digjitale në Kosovë (kode) (ME-BB)
4	Emergjencia Covid-19 në Kosovë (MSH - BB)
5	Pronat dhe Infrastruktura gjeo-hapësinore (AKK-BB)
6	Komunat për rininë në Kosovë MAPL
7	Reformën në sistemin e Asistencës Sociale (MFPT)
8	Programi për shfrytëzimin dhe nxitjen e mundësive për sigurinë e ujit (MMPHI)



**B. AUDITIMET E PERFORMANCËS****Tema të auditimeve të performancës [6]**


Temat nën auditim	
1	Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave nga zonat rurale përmes përfshirjes së tyre në tregun e punës
2	Lista e pritjes së pacienteve
3	Licencimi i mediave
4	Prishtina Parking
5	Sponsorizimi i sportit
6	Menaxhimi i tokave/pronës nga Instituti Bujqësor i Kosovës

**Tema të auditimeve të prokurimit [7]**

Temat nën auditim	
1	Menaxhimi i sektorit të ndërtimit në Kosovë
2	Kontratat e Institucioneve publike të Republikës së Kosovës me organizatën Caritas Kosova
3	Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës-Infrakos (projekti i rehabilitimit të linjës 10 Hani i Elezit-Leshak
4	Shitjet direkte - AKP
5	Auditimi përcjellës për Efikasitetin e Menaxhimit të Lëndëve në Gjykatat Themelore.
6	Dokumentimi dhe verifikimi i performancës komunale për vitin 2020
7	Efektiviteti i mekanizmave të sigurimit të cilësisë së të dhënave të raportuara për SMPK dhe GPK

**Tema të auditimeve të teknologjisë së informacionit [3]**

Temat nën auditim	
1	Sistemit i Menaxhimit të Stokut Farmaceutik (SMSF)
2	Modernizimi i Sistemit të Edukimit në Kosovë përmes e-Edukimit
3	ASYCUDA World



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Lagjja Arbëria  
Rr. Ahmet Krasniqi, 210  
10000 Prishtina  
Republika e Kosovës